



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 10.7.2018

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DENONCIMIN E MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË,
PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2010, PËR PROJEKTIN “EFIÇENCA
ENERGJETIKE PËRMES SEKTORIT BANKAR”, RATIFIKUAR ME LIGJIN 89/2015”**

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 10 korrik 2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar”, ratifikuar me ligjin 89/2015”. Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Jurgis Çyrbja. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, si dhe në nenin 29 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj ka për qëllim denoncimin e marrëveshjes së bashkëpunimit financiar 2010, të nënshkruar më 6.7.2015, për projektin: “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar”, ratifikuar me ligjin 89/2015, ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Me anë të këtij projektakti synohet tërheqja nga marrëveshja, e cila vlerësohet të jetë e pazbatueshme dhe, në këtë mënyrë, t’i hapet rrugë nënshkrimit të një marrëveshjeje të re për mbështetjen e projektit “Promovimi i ndërmartjeve të vogla dhe të mesme përmes Fondit të Garancisë së Kredive Rurale”.

Shkak për moszbatimin e marrëveshjes ka qenë se, për shkak të likuiditetit të lartë në sektorin financiar shqiptar, rezultoi që kjo nismë nuk ishte efiçente për bankat shqiptare. Kjo pasi në Shqipëri, sipas palës gjermane, pengesa më e madhe për dhënien e kredive nuk ishte mungesa e mjeteve financiare, por mungesa e garancive nga ana e kredimarrësve.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

-**Në aspektin ligjor** projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

-**Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi me votat e shumicës së anëtarëve dhe vendosi t’ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATOR

Jurgis ÇYRBJA

KRYETARI

Ulsi MANJA